



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I EDUKIMIT**

Rr. Agim Ramadani, Fakulteti i Edukimit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +383 38 229 201 • E-mail: edukimi@uni-pr.edu • edukimi.uni-pr.edu

Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" Fakulteti i Edukimit

Programi i studimit:
Master i Edukimit për STEAM

Niveli i studimeve:

Master

Numri i kredive:

120 ECTS

Akredituar për periudhën:

1 Tetor 2023 - 30 Shtator 2026

PËRMBAJTJA

1. QËLLIMI DHE PROFILI I PROGRAMIT TË STUDIMIT	3
2. REZULTATET E TË NXËNIT TË PROGRAMIT.....	4
3. PROGRAMI STUDIMOR: Master i Edukimit për STEAM	5
4. PËRSHKRIMET E KURSEVE	7

1. QËLLIMI DHE PROFILI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Programi Master i Edukimit STEAM është program 2-vjeçar i përbërë nga 120 kredi (ECTS). Programi ofron zhvillimin e aftësive teorike dhe praktike në një për zgjedhje të gjerë temash në fushën e arsimit me synim të avancimit të shkathtësive të punonjësve të sistemit të arsimit për përmirësim të cilësisë së mësimdhënies, shkollës dhe sistemin e arsimit në përgjithësi. Programi synon të kontribuojë në promovimin e qasjeve inovative dhe ndërdisiplinore për mësimdhënien dhe të nxënit STEAM në arsim. Programi do t'ju mundësojë studentëve, mësimdhënëve dhe profesionistëve të fitojnë njohuri dhe shkathtësi për të nxitur ndryshimin arsimor në përgjigje të një bote gjithnjë e më teknologjike dhe të pasur me shkencë.

Misioni i programit Master i Edukimit STEAM është në përputhje me deklaratën e përgjithshme të misionit të Fakultetit. Ky program ofron një përvojë unike përmes të cilit mësimdhënësit dhe profesionistët arsimor angazhohen në hulumtime dhe praktika që rezultojnë në inovacione dhe përmirësim të vazhdueshëm të mësimdhënies duke integruar shkencën, artin, inxhinierinë, shëndetin dhe edukimin fizik, matematikën, muzikën dhe teknologjinë. me qëllimin përfundimtar për të siguruar edukimin STEAM për të gjithënxënësit. Shfrytëzimi i përvojave shkencore dhe hulumtimeve të integruara, pedagogjisë bashkëkohore dhe integrimi i tyre me teknologjitë moderne janë bazë e programit Master i Edukimit STEAM.

Objektivat e programit janë:

- Arsimimi i mësimdhënësve për të udhëhequr edukimin për STEAM me bazë në shkollë;
- Krijimin sinergjive për të nxënit lëndor dhe të integruar;
- Zbatimin e njohurive të integruara dhe zhvillim të shkathtësive të shekullit të 21-të;
- Mbështetja e mësimdhënies aktive dhe gjithëpërfshirëse për planifikime dhe zbatime të aktiviteteve në fushat e integruara të STEAM;
- Përdorimi i kurrikulës formale dhe joformale dhe mbështetjes së komunitetit

2. REZULTATET E TË NXËNIT TË PROGRAMIT

Bazuar në qëllimin dhe profilin e programit, në përfundim të studimeve, të diplomuarit do të jenë në gjendje të:

1. Shqyrtojnë parimet bazë të edukimit STEAM për krijimin e mjedisit motivues dhe ftues të nxënit;
2. Zhvillojnë kompetencën në promovimin e edukimit STEAM përmes integritit të kurrikulës dhe mësimi të integruar;
3. Zbatojnë njohuritë mbi përmbajtjen pedagogjike për planifikimin e mësimdhënies dhe vlerësimin për edukimin e integruar STEAM;
4. Zhvillojnë njohuri dhe aftësi për aplikimin e teknologjisë dhe dizajnit inxhinierik në zgjidhjen e problemeve;
5. Kultivojnë një frymë inovacioni në promovimin e edukimit STEM me bazë në shkollë;
6. Përdorin metoda kërkimore dhe rezultate të përshtatshme për zhvillimin e njohurive të reja teorike dhe praktike në arsim;
7. Vlerësojnë përparimin e nxënësve dhe planifikojmë aktivitete të bazuara në matje përmes formave dhe instrumenteve të ndryshme të vlerësimit;
8. Krijojnë qëndrime pozitive ndaj zhvillimit të qëndrueshëm dhe shfrytëzojnë materiale të ripërdorshme në mësimdhënie dhe për të nxënë;
9. Kontribuojnë bashkë me komunitetin për zhvillimin e edukimit jo formal STEAM.

3. PROGRAMI STUDIMOR: Master i Edukimit për STEAM

Viti I					
Semestri I			Orë/javë		
Nr.	O/Z	Lëndët	L	U	ECTS
1	O	Teori e Mësimimit dhe e Kurrikulës	2	2	6 ECTS
2	O	Psikologjia e Edukimit	2	1	5 ECTS
3	O	Metodat e Hulumtimit në Arsim	2	2	6 ECTS
4	O	Didaktika, Epistemologjia dhe Hyrje në edukimin STEAM	2	1	5 ECTS
5	Z	1. Perspektiva Kritike dhe Politika në Edukimin STEAM 2. Politikat Arsimore dhe Legjislacioni	2	0	4 ECTS
6	Z	1. Qëndrueshmëria në Kontekstin STEAM 2. Edukimi për Zhvillim të Qëndrueshëm	2	0	4 ECTS
Studenti zgjedh 2 lëndë zgjedhore: - Një nga kurset e renditura në 5 dhe një nga kurset e renditura në 6.					
			12	6	30 ECTS
Semestri II			Orë/javë		
Nr.	O/Z	Lëndët	L	U	ECTS
1	O	Shfrytëzimi i teknologjisë në arsim	2	2	6 ECTS
2	O	Dizajni, Zhvillimi dhe Vlerësimi i Kurrikulave në Edukimin STEAM	2	1	5 ECTS
3	O	Procesi i dizajnit inxhinierik në Edukimin STEAM	2	2	6 ECTS
4	O	Vlerësimi në STEAM	2	1	5 ECTS
5	Z	Edukimi special dhe inkluziv në STEAM Praktika bashkëkohore në edukim inkluziv	2	0	4 ECTS
6	Z	Të nxënit ndërdisiplinor Edukimi STEAM në mjediset e të mësuarit joformal	2	0	4 ECTS
Studenti zgjedh 2 lëndë zgjedhore: - Një nga kurset e renditura në 5 dhe një nga kurset e renditura në 6.					
			12	6	30 ECTS
Viti II					
Semestri III			Orë/javë		
Nr.	O/Z	Lëndët	L	U	ECTS

1	O	Praktika mesimore për STEAM	2	2	5 ECTS
2	O	Statistikat e Aplikuara në Edukimin STEAM	2	1	5 ECTS
3	O	Dizajni dhe mjetet mësimore STEAM	2	2	6 ECTS
4	O	Kreativiteti dhe Inovacionet në Edukimin STEAM	2	2	6 ECTS
5	Z	Dizajni dhe shkrimi i punimeve shkencore Reforma Organizative në Edukimin STEAM Arti në STEAM	2	0	3 ECTS
6	Z	STEAM në edukimin parashkollor STEAM në edukimin Fillor STEAM në Arsimin e Mesëm STEAM në Arsimin e Lartë	2	1	5 ECTS
Studenti zgjedh 2 lëndë zgjedhore: - Një nga kurset e renditura në 5 dhe një nga kurset e renditura në 6.					
			12	8	30 ECTS
Semestri IV			Orë/javë		
Nr.	O/Z	Lëndët	L	U	ECTS
1	O	Hulumtimi i Veprimit në edukimin STEAM	2	1	5 ECTS
2	O	Barazia në Edukimin STEAM	2	1	5 ECTS
3	O	TEZA E MASTERIT	20		20 ECTS
			24	2	30 ECTS

4. PËRSHKRIMET E KURSEVE

Përshkrimi për secilin kurs

TEORI E MËSIMIT DHE E KURRIKULËS (O)

Kursi ofrohet për të promovuar bazën historike, filozofike e pedagogjike të procesit mësimor dhe përqëndrohet nëpërgatitjen teorike dhe praktike të studentëve për zbatimin e kurrikulës. Gjtë kursit do të diskutohen çështjet: mësimdhënia, veçoritë dhe problemete saj, stilet e të nxënës, metodat e mësimdhënies, teoritë e tënxënës (bihevizorizmi, kognitivizmi, konstruktivizmi dhe humanizmi), faktorët mësimorë dhe ndërveprimi i tyre, personaliteti i mësimdhënësit, njohuritë për fushat, kompetencat, rezultatet e tënxënës dhe integrimin ndërkurrikular, praktikën e planifikimit të mësimit dhe vlerësimi formativ dhe përmbledhës. Studentët do të kenë mundësinë të analizojnë qasjet kryesore kurrikulaëre dhe efektet e tyre në procesin e mësimdhënies dhe tënxënës si dhe të promovojnë zhvillimin e të menduarit kritik dhe kreativ.

PSIKOLOGJI E EDUKIMIT (O)

Psikologjia e Edukimit synon të jap njohuri mbi zhvillimin, tënxënës dhe mësimdhënien. Natyra e edukimit përmes STEM kërkon qasje sistemike në tënxënës, prandaj psikologjia e edukimit me të drejtë konsiderohet disiplinë që ndihmon të kuptuarit dhe mbështetjen e procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies përmes STEM. Shpesh, studentët “luftojnë” me STEM sepse janë ndikuar nga stereotipe të ndryshme rreth lëndëve, ose meqë humbin besimin tek vetja, krijojnë pritshmëri të vogla etj. Disa kanë vështirësi me metodat tipike të mësimdhënies që përdoren për të edukuar studentët në lëndët STEM. Përmes psikologjisë së edukimit tentojmë të arsyetohet se jo të gjithë kanë aftësi të tilla të cilat përshtaten natyrshëm me matematikën, inxhinierinë etj. Andaj qasja psiko-pedagogjike ka shumë rëndësi, këta studentë duhet të dinë se është në rregull nëse u duhet më shumë kohë për të kuptuar materialin sesa shokët e tyre të klasës ose nëse provojnë metoda të ndryshme të të mësuarit. Kursi do të përfshijë zbatimin e psikologjisë në studimin e zhvillimit, tënxënës, mësimdhënies, motivimit dhe çështjeve tjera që ndërliiden me procesin e edukimit. Teoritë e të mësuarit dhe zhvillimit, në këtë lëndë, do të konceptohen si një grup lentesh nëpërmjet të cilave të perceptohen dhe interpretohen veprimtaritë edukative në kuadër të STEM. Kursi do të përfshijë trajtimin e çështjeve psikologjike të përfshira në fushën e edukimit si dhe aplikimin praktik të parimeve psikologjike të mësimdhënies. Thëks i veçantë do të vendoset tek tënxënës, mësimdhënia, motivimi, kreativiteti në klasë, dhe ndikimet që ka mjedisi në dinamikën mësimdhënie-mësimnxënie në kuadër të STEM.

METODAT E HULUMTIMIT NË ARSIM (O)

Ky kurs fokusohet në paradigmat, çështjet dhe metodat e hulumtimeve në arsim. Temat që përfshihen në këtë kurs janë: përkufizimi i metodave të ndryshme të hulumtimeve, analiza kritike e literaturës, grumbullimi i të dhënave sasiore dhe atyre cilësore nga mjediset e tënxënës, natyra dhe llojet themelore të hulumtimeve, të lexuarit kritik dhe interpretimi i hulumtimeve, Studentët do të bëhen “lexues kritik” në mënyrë që të analizojnë hulumtimet sasiore dhe cilësore në fushën e edukimit dhe të shfrytëzojnë rezultatet kërkimore në realizimin e hulumtimeve të tyre për përmirësimin e praktikave të mësimdhënies dhe tënxënës. Konceptet e adresuar nga aspekti teorik, do të trajtohen gjithashtu nga qasja praktike (dhe më e detajuar) e realizimit të një projekti hulumtues. Kursi ka për synim t’i ekspozojë studentët ndaj hapave kryesorë nëpër të cilët duhet të kalohet gjatë realizimit të një projekti hulumtues. Kursi trajton metodat kualitative, kuantitative dhe të përziera të hulumtimeve arsimore. Në mënyrë të tërthortë kursi trajton llojet e ndryshme të hulumtimeve si përshkruese, historike, eksperimentale, vlerësuese, vepruese, studime rasti etj. Në kuptim më të ngushtë, kursi ndihmon studentët të familjarizohen me konceptin e zgjidhjes dhe definimit të problemit, dizajnin e një projekti hulumtues, hartimin e instrumenteve dhe mbledhjen e të dhënave sasiore dhe cilësore, si dhe procesimin, analizën dhe raportimin e të dhënave dhe të gjetjeve të një studimi. Në kuptim më të përgjithshëm, kursi ndihmon studentët të reflektojnë rreth parimeve etike ligjore dhe filozofike të realizimit të një projekti hulumtues si p.sh. hulumtueshmëria, besueshmëria, validiteti, përgjithësimi dhe

ruajtja e anonimitetit. Natyra e temave dhe problematikës që do të adresojë kursi do të jenë në përputhje me natyrën e programit dhe si të tilla do të orientojnë studentët edhe drejt kuptimit të problemeve dhe çështjeve kryesore brenda fushës së ngushtë të programit.

DIDAKTIKA, EPISTEMOLOGJIA DHE HYRJE NË EDUKIMIN STEAM (O)

Ky kurs prezanton themelet e disiplinave arsimore STEAM (shkencës, teknologjisë, inxhinierisë, arteve dhe matematikës) dhe strategjitë e përdorura për të ofruar edukim integruar STEAM në mjedise formale dhe joformale. Natyra e disiplinave të edukimit STEAM, konceptet ndërsektoriale, pedagogjia STEAM, strategjitë e mësimdhënies, të nxënimit integruar STEAM, karriera STEAM dhe mësimdhënie të bazuar në probleme kontekstuale do të trajtohen. Në këtë lëndë studentët do të mësojnë më shumë rreth hapave hyrës të edukimit STEAM, epistemologjisë STEAM, parimeve didaktike dhe metodologjisë. Do të prezantohen metodat kryesore të mësimdhënies STEAM. Gjithashtu do të përpiqet të japë përgjigje ose informacionin e nevojshëm për disa pyetje si p.sh se Çfarë është epistemologjia e STEAM?, Si mund të mësojmë STEAM? Cilat janë parimet shkencore të STEAM mbi të cilat ne mbështetemi për të mësuar? Çfarë duhet t'i kushtojmë vëmendje kur zbatojmë STEAM?, Çfarë metodash dhe qasjesh duhet të përdorë shkolla për të zbatuar mësimin STEAM dhe STEAM?, Cila është metoda më e mirë e mësimdhënies për t'u ndjekur? Studentët do të gjejnë informacion në lidhje me mjediset mësimore STEAM, përdorimin e projekteve studentore si një mënyrë për të përshtatur mësimin ndërdisiplinor STEAM në kurrikulën ekzistuese, Të mësuarit e bazuar në projekte, Të mësuarit e bazuar në probleme, mësimi i bazuar në zgjidhjen e problemeve në bashkëpunim, mësimi i bazuar në kërkim, dhe strategji të tjera të të nxënimit aktiv. Gjatë kursit do të inkurajohet të menduarit kritik e krijues dhe bashkëpunimi gjatë zgjidhjes së problemeve. Strategjia mësimore do të bazohet në angazhimin e studentëve gjatë ligjeratave me aktivitete praktike (hands on activities) ku studentët do të ofrojnë produkte konkrete të të nxënimit (mësuarit) (artefakte të ndërtuara nga vetë studentët); bazuar në këto artefakte, mesimdhënesit e kursit do të jenë në gjendje të kryejnë vlerësim formativ e edhe përmbledhës.

PERSPEKTIVA KRITIKE DHE POLITIKA NË EDUKIMIN STEAM (Z)

Qëllimi i këtij kursi është të eksplorojë në mënyrë kritike peizazhin vazhdimisht në ndryshim të politikave arsimore dhe sociale. Studentët do të zhvillojnë një angazhim kritik me ndikimet sociale dhe politike në arsim përtë zhvilluar vendimmarrje të informuar për drejtësinë sociale në mësimdhënie dhe të nxënimit. Përveç kësaj, studentët do të ndërtojnë thellësi të të kuptuarit në perspektivat kritike për identitetin dhe përkatësinë në arsim, mënyrat në të cilat diversiteti (kapitali klasor dhe kulturor, gjinia/ seksualiteti, ndër/multikulturalizmi/raca, feja) është në tension me privilegjimin sistematik institucional. Studentët gjithashtu do të angazhohen në vetë-reflektim ndërsa eksplorojnë këndvështrime të ndryshme mbi mësimdhënien dhe të nxënimit STEAM. Kursi do të shqyrtojë se si çështjet e fuqisë, kulturës dhe vetëdijes formësojnë edukimin STEAM, sistemin arsimor STEAM dhe hulumtimin arsimor STEAM.

POLITIKAT ARSIMORE DHE LEGJISLACIONI (Z)

Përmbajtja e shkurtër: Kursi ka për qëllim të ndihmojë studentët të kuptojnë qartë konceptin e politikës arsimore dhe kuptimin e tyre në praktikë. Në veçanti kursi do të shtjellojë kontekstin e politikave arsimore në Kosovë duke synuar një analizë kritike të tyre në lidhje me traditat e ndryshme të funksionimit të sistemeve arsimore duke analizuar ato krahas trendeve globale të reformës arsimore nën frymën neoliberales (me fokus në edukimin STEAM). Përveç kësaj, moduli do të të vë në dukje për studentët ciklin e politikave, duke përfshirë një orientim praktik për hartimin e politikave, monitorimin dhe vlerësimin e tyre. Në këtë kontekst do të shtjellohen dimensione praktike të perceptimit të politikave në nivel Kosove dhe do të shtjellohet procesi praktik i hartimit të legjisllacionit primar dhe sekondar.

QËNDRUESHMËRIA NË KONTEKSTIN STEAM (Z)

Edukimi për zhvillim të qëndrueshëm është pjesë e Kurrikulës si çështje ndërkurrikulare. Megjithatë integrimi i mirëfilltë ende nuk ka filluar para së gjithash për shkak të mungesës së një konize se si të

integrohen çështjet e qëndrueshmërisë vertikalisht dhe horizontalisht në Kurrikulë. Studenti me këtë kurs do të pajiset me njohuri mbi metodologjitë e integritit të çështjeve të zhvillimit të qëndrueshëm në kurrikulën shkollore K-12.

EDUKIMI PËR ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM (Z)

Zhvillimi i qëndrueshëm është korniza e politikbërjes globale sot, dhe pjesë integrale e kurrikulave nacionale në shumicën e vendeve të botës. Në Kosovë, edukimi për zhvillim të qëndrueshëm është pjesë e Kurrikulës si çështje ndërkurrikulare që nga viti 2011. Studenti-mësimdhënës me këtë kurs do të pajiset me njohuri shkencore mbi konceptet themelore mjedisore dhe parimet e zhvillimit të qëndrueshëm, raportin e njeriut me mjedisin jetësor dhe zhvillimin socio-ekonomik si dhe rolin e edukimit të gjeneratave të reja për zhvillimin e qëndrueshëm.

SHFRYTËZIMI I TEKNOLOGJISË NË ARSIM (O)

Kursi synon që të zhvillojë në mënyrë teorike dhe praktike njohuritë lidhur me konceptet dhe llojet kryesore të Teknologjive të reja të Edukimit dhe atyre të Internetit për mbështetje të mësimdhënies dhe procesit të të nxënit. Kursi shtjellon konceptet multimediale dhe interaktive në mjedise të reja të mësimdhënies dhe të të nxënit. Kursi fokusohet në aftësimin teorik dhe praktik të studentëve për të shfrytëzuar: teknologjitë për mësimdhënie dhe të nxënë aktiv, TIK-un si medium dhe vegël mbështetëse për praktikatat inkluzive, platformat për mësimdhënie, simulatorët e ndryshëm për realizimin e eksperimenteve dhe animacioneve kompjuterike në edukim, teknologjitë e bashkëpunimit të mbështetura nga kompjuteri, teknologjitë për vlerësim, teknologjitë e të nxënit elektronik në kontekst, si dhe teknologjitë për krijimin e materialeve interaktive që mundësojnë mësimdhënie dhe të nxënë interaktiv. Studentët poashtu mësojnë se si t'i vlerësojnë Teknologjitë e Edukimit dhe ato të Internetit për nga aspekti i ngritjes së performancës së mësimdhënies dhe të nxënit për të mbështetur të menduarit kritik, kreativitetin, inovacionin, monitorimin dhe aktivitetet mësimore në një perspektivë gjithëpërfshirëse.

DIZAJNI, ZHVILLIMI DHE VLERËSIMI I KURRIKULAVE NË EDUKIMIN STEAM (O)

Në këtë kurs do të shqyrtohet rëndësia e kurrikulës së edukimit STEAM, si një qasje e re dhe thelbësore për shekullin e 21-të. Konceptet e modeleve të dizajnit të kurrikulës STEAM, faktorët që ndikojnë në zhvillimin dhe implementimin e kurrikulës për STEAM, ndryshimet dhe inovacionet dhe vlerësimi i kurrikulave që integrojnë fushat e STEAM janë temat që shqyrtohen, analizohen dhe janë pjesë e detyrave për studentët që vijojnë këtë kurs.

PROCESI I DISAJNIT INXHINIERIK NË EDUKIMIN STEAM (O)

Fokus i procesit të disajnit inxhinierik është hulumtimi ndërlidhjes midis të kuptuarit konceptual dhe aplikimit në botën reale. Studentët do të eksplorojnë strategji për angazhimin e tyre në të mësuarit e strukturuar të kërkimit për të rritur të kuptuarit në disiplinat e ndryshme dhe për të siguruar transferimin e njohurive. Studentët do të angazhohen në proceset e disajnit inxhinierik të zgjidhjes së problemeve të hapura dhe do të mësojnë se si të mësojnë. Kursi do t'i inkurajojë studentët të mësojnë nga dështimi dhe të ushqejnë aftësitë e tyre për të krijuar zgjidhje novatore për sfidat në temat e edukimit STEAM.

VLERËSIMI NË STEAM (O)

Kursi shqyrton aspektet dhe praktikatat e vlerësimit në STEAM që influencojnë cilësinë e mësimdhënies dhe reformën në shkollë në përgjithësi. Në mënyrë më të theksuar, kursi adreson aspektet e planifikimit dhe realizimit të vlerësimit sipas STEAM në qasjen e bazuar në kompetenca në kuadër kurrikulare në Kosovë. Aspektet tjera të vlerësimit si: politikat arsimore për vlerësimin, qëllimet dhe parimet e vlerësimit, ndërlidhja e vlerësimit me mësimdhënien, llojet e vlerësimit. Për më shumë, kursi trajton në hollësi edhe llojet e ndryshme të vlerësimit si mundësit dhe përfitimet e vlerësimit, vlerësimi formative, përmbledhës dhe mësimi STEAM. Vlerësimi i vazhdueshëm, vlerësimi për të nxënë (formativ) dhe vlerësimi i të nxënit (përmbledhës) si dy koncepte që formësojnë vlerësimin që i bëjnë mësimdhënësit nxënësve ndërsa nga

aspekti praktik kursi ekspozon nxënësit ndaj metodave të ndryshme të vlerësimit si: vlerësimi i bazuar në portfolio, vlerësimi i bazuar në performancë, vlerësimi i punimeve të shkruara, testet dhe cilësia e tyre. Përveç kësaj, kursi adreson edhe aspektet sistematike të vlerësimit si vlerësimet e jashtme kombëtarë dhe vlerësimi i programeve. Kursi poashtu do të mbulojë edhe temën e vlerësimeve ndërkombëtarë si TIMSS dhe PISA.

EDUKIMI SPECIAL DHE INKLUZIV NE STEAM (Z)

Kursi ofron njohuri të avansuara nga fusha e edukimit special dhe inkluziv dhe zhvillon shkathtësi për klasifikim të personave – nxënësve sipas dëmtimeve që kanë. Trajtohen tema që ndërlidhen me strategjitë e mësimdhënies me nxënës me vështirësi në të nxënë si pasojë e zhvillimit të vonuar mendor, dëmtimeve në të parë, në të dëgjuar, vështirësi në të folur, vështirësi specifike në të nxënë (disleksi, disgrafi, diskalkuli, dispraksi). Përmes këtij kursi, zhvillohen shkathtësi të planifikimit individual të edukimit dhe të dizajnit iniversal të të nxënit. Gjithashtu, analizohen trendet drejt edukimit inkluziv në nivel ndërkombëtar dhe vendor.

PRAKTIKA BASHKËKOHORE NË EDUKIM INKLUZIV (Z)

Përmbajtja e shkurtër: Kursi ofron njohuri të avancuara nga fusha e edukimit inkluziv. Në këtë kurs trajtohen tema që kanë të bëjnë me përkufizimet bashkëkohore të edukimit inkluziv, filozofinë e edukimit inkluziv, format e inkluzionit në vende evropiane e më gjerë, nxënësit me nevoja të vecanta, dëmtimet e natyrave të ndryshme: në të dëgjuar, në të parë, prapambetje mendore, vështirësi në komunikim, vështirësi emocionale dhe në sjellje. Kursi ofron mundësi të debatimit të problemeve, të sfidave dhe tendencave të edukimit inkluziv në vende të ndryshme të botës duke i ndërlidhur me kontekstin kosovar. Gjithashtu, zhvillohen shkathtësi të planifikimit të suksesshëm dhe të zbatimit parimeve, strategjive të edukimit inkluziv të cilat shprijnë në drejtim të krijimit të një klase, një mësimdhënësi një shkollë dhe një sistemi arsimor inkluziv.

TË NXËNIT NDËRDISIPLINOR (Z)

Të nxënit ndërdisiplinorë është qasje ku integrohen disiplinat e ndryshme shkencore për të formuar një fushë të re lëndore. Disiplinat shkencore kanë kontribuar në njëra tjetrën duke bërë që ato të kenë një zhvillim të hovshëm dhe duke i bërë të suksesshme në studime eksperimentale. Qajsa ndërdisiplinore ju ndihmon studentëve të kuptojnë fenomenet dhe problemet shkencore që paraqiten në kontekste të jetës reale dhe përballimin me këto feniomene duke përdorur aftësi dhe njohuri që lidhen me ndonjë nga disiplinat përkatëse. Të nxënit ndërdisiplinor krijon studentë kompetent dhe të përgatitur me shkathtësi për zgjidhjen e problemeve duke nxitur të menduarin kritik. Zhvillimi i praktikave ndërdisiplinore dhe të integruara në procesin e mësimdhënies dhe të nxënit STEAM, ndihmon në procesin e ndërtimit të urës midis institucioneve akademike dhe industrisë.

EDUKIMI STEAM NË MJEDISËT E TË MËSUARIT JOFORMAL (Z)

Ky kurs fokusohet në qasjet mësimore të bazuara në STEAM dhe praktikat më të mira, duke përfshirë mënyrën se si mësimdhënësit në mjediset joformale strukturojnë aktivitetet dhe burimet e të mësuarit gjatë një programi arsimor STEAM. Kursi synon që studentet të njihen me mjedisin e të mësuarit joformal, konkretisht hapësirë krijuese makerspace, ku do të zhvillohen projektet të ndryshme mbi përdorimi dhe aplikimin e pjesëve për ndërlidhjen e arsimit joformal me atë formal.

Kursi u ofron mundësi studentëve që përmes përdorimit të makerspace të kenë mundësi të bëjnë integrimin e aktivitetve ekstra kurrikulare në proceset e të mësuarit joformal STEAM.

PRAKTIKA MËSIMORE PËR STEAM

Ky kurs është i dizajnuar që studentët e programit Master i Edukimit për STEAM, krahas punës së bërë në të gjitha kurset e programit, të kenë mundësi të kristalizojnë njohuritë e tyre edhe në aspektin praktikë. Të njohin vetën e tyre, kompetencat e fituara dhe zbatimin praktik të tyre në tregun e mundshëm të punës.

Mësimi praktik përfshinë dy komponente të cilat janë ngushtë të lidhura njëra me tjetrën:

- Mësimin praktik në Fakultet (përgatitja teorike) i cili ka dy qëllime primare: (i) t'u ofrojë studentëve përgatitjen që u duhet atyre për të qenë të suksesshëm në klasa/laboratore/hapësira punuese, dhe (ii) t'u ofrojë atyre kohë dhe strukturë për reflektim dhe diskutim, për ta mundur nxënien nga koha që kanë kaluar në klasë/laboratore/hapësira punuese.
- Mësimi praktik në shkolla/qendra të arsimit joformal i cili synon që studentët të zhvillojnë njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet e caktuara për të qenë mësimdhënës ose instruktor në qendrat e arsimit joformal si dhe të zbatojnë strategji të ndryshme të cilat shpiejnë drejt zhvillimit të tyre si fasilitues të të nxënës. Kjo pjesë përfshinë edhe zhvillimin e aftësive për të krijuar dhe menaxhuar një ambient kultivues dhe përkrahës të nxënës. Për të planifikuar dhe mbajtur mësim sipas një planprogrami të caktuar dhe për t'u njohur me funksionimin e shkollës si organizatë, apo edhe rolin dhe funksionin e qendrave të arsimit joformal.

STATISTIKAT E APLIKUARA NË EDUKIMIN STEAM (O)

Ky kurs diskuton disa nga aspektet matematikore dhe shkencore të të dhënave empirike, ose të dhënave të bazuara në zgjidhjen e problemeve. Temat do të përfshijnë metodat për hartimin e eksperimenteve dhe anketimeve; dhe analizën e të dhënave duke përdorur modele statistikore. Shembujt do të ilustrojnë zbatimin e këtyre metodave në shkencat e edukimit në përgjithësi dhe në fushën e edukimit matematikor në veçanti.

DIZAJNI DHE MJETET MËSIMORE STEAM (O)

Përmbajtja e shkurtër: Ky kurs fokusohet në përmbajtjen mësimore të STEAM, e cila përfshin përafrimin e lëndëve (si mësimdhënësit paraqesin materiale nga disiplina të shumta ose fusha të përmbajtjes në mënyra të qarta dhe të lidhura), integrimin e disiplinës (përzgjedhja e materialit nëpër disiplina - duke përfshirë konceptet, metodat, dhe qasjet - si dhe se si ato sintetizohen për të mbështetur mësimin më të thellë), dhe mënyrat për të përdorur aftësitë e zgjidhjes së problemeve. Këto aftësi përfshijnë aftësitë njohëse (modelimi, analizimi, interpretimi), aftësitë bashkëpunuese (komunikimi, zgjidhja e problemeve) dhe aftësitë krijuese (dizajnimi, krijimi) të nevojshme për të mësuarit e shekullit të 21-të.

KREATIVITETI DHE INOVACIONET NË EDUKIMIN STEAM (O)

Kursi angazhon studentet në procesin e kërkimit gjatë zgjidhjes së problemeve dhe detyrave të pasura në STEAM. Theksi vihet në zhvillimin e një koncepti të mësimdhënies, nga idea kreative tek produkti inovator final duke ngritur njohuritë mbi mundësitë dhe veglat që studentet mund të përdorin për të gjeneruar mësimdhënie inovatore në klasat e tyre duke përdorur teknologjinë. Përmes kesaj qasje brenda këtij kursi ofrohen njohuri konkrete për aplikacione specifike dhe udhëzime praktike në zhvillimin e mjeteve të tyre unike STEAM, duke ju ofruar ndjesinë dhe mundësinë për të përjetuar dhe eksperimentuar mësimin STEAM në klasat e tyre. Poashtu përmes kësaj kursi studentët aftësohen për aplikimin e mësimdhënies në bazuar në projekte për zgjidhjen e problemeve nga jeta reale duke u angazhuar në aktivitete mësimore të bazuara në grupe, të bazuara në problem dhe në përvojë, në mënyrë që të rrisin aftësitë e tyre krijuese dhe inovative.

DIZAJNI DHE SHKRIMI I PUNIMEVE SHKENCORE (Z)

Studentët informohen për karakteristikat e përgjithshme të shkrimit shkencor dhe specifikat e hulumtimit për edukimin STEAM. Ata mësojnë rreth revistave kombëtare dhe ndërkombëtare të indeksuara në platforma me impakt faktor dhe janë të rëndësishme për disiplinën e edukimit STEAM; dhe rreth bazave të tjera të të dhënave. Ata mund të përdorin njohuritë e fituara teorikisht në praktikë duke përgatitur një hulumtim shkencor në edukimin STEAM. Ky kurs synon të realizojë procesin e të shkruarit dhe të mësojë bazat e shkrimit efektiv shkencor. Udhëzimi do të fokusohet kryesisht në procesin e shkrimit dhe botimit të dorëshkrimeve shkencore. Lënda synon të kualifikojë studentët për shkrimin e punimeve shkencore dhe prezantimin e tyre para publikut ekspert. Studentët zhvillojnë aftësinë për të përgatitur një kontribut me punë kërkimore origjinale që zgjeron kufijtë e njohurive dhe është thelbësore në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Studentët zhvillojnë gjithashtu aftësinë për të komunikuar në lidhje me ekspertizën e tyre me kolegët e tyre, komunitetin më të gjerë shkencor dhe shoqërinë. Qëllimi i kursit është të lehtësojë studentët

në përvetësimin e aftësive të kërkimit dhe rishikimit të literaturës dhe hartimit të kërkimit dhe shkrimit të propozimeve. Lënda fokusohet në sigurimin e studentëve me të gjitha njohuritë e nevojshme për shkrimin dhe prezantimin shkencor.

REFORMA ORGANIZATIVE NË EDUKIMIN STEAM (Z)

Ky kurs fokusohet në zhvillimin e koncepteve, aftësive dhe teknikave kryesore të kërkuara nga menaxherët/drejtorët dhe profesionistët e mësimdhënies për të mbështetur dhe lehtësuar ndryshimin e organizatës dhe për të mësuar se si të bëhen ndryshime sistematike në arsim në mënyra që ndikojnë pozitivisht në system.

ARTI NË STEAM (Z)

Kursi ART në STEAM eksploron fuzionin emocionues të artit dhe shkencës, duke integruar shprehjen krijuese me parimet e Shkencës, Teknologjisë, Inxhinierisë dhe Matematikës (STEM). Ky kurs ndërdisiplinor synon të frymëzojë studentët të mendojnë në mënyrë kritike, të zgjidhin probleme dhe të shprehin idetë e tyre përmes medimeve të ndryshme artistike. Në këtë kurs, studentët do të nisin një udhëtim ku do të zbulojnë lidhjet e qenësishme midis artit dhe fushave të STEM. Nëpërmjet projekteve praktike, aktiviteteve bashkëpunuese dhe diskutimeve tërheqëse, studentët do të eksplorojnë se si arti mund të përmirësojë kuptimin tonë të koncepteve shkencore, të ndezë kureshtjen dhe të nxisë të menduarit inovativ. Studentët do të angazhohen në praktika të ndryshme artistike gjatë gjithë kursit, duke përfshirë vizatimin, pikturën, skulpturën, artin dixhital, mediat e përziera dhe më shumë. Ata gjithashtu do të eksplorojnë integrimin e teknologjisë dhe mjeteve dixhitale në krijimet e tyre artistike, duke u mundësuar atyre të përdorin mjetet më të fundit për të përmirësuar proceset e tyre artistike. Ky kurs synon të nxisë një kuptim ndërdisiplinor të integritit të lëndëve STEAM duke zhvilluar aftësitë artistike dhe kreativitetin, duke promovuar të menduarit kritik dhe zgjidhjen e problemeve. Kursi do të inkurajojë studentët në praktikat e bashkëpunimit dhe komunikimit.

STEAM NË EDUKIMIN PARASHKOLLOR (Z)

Ky kurs është dizajnuar me qëllim që të shqyrtohet dhe kuptohet rëndësia e përdorimit të qasjes STEAM qysh në fëmijëri të hershme. Benefitet e saj dhe mundësitë që ka kjo qasje në zhvillimin e potencialit të fëmijës që nga fëmijëria e hershme. Përmes mësimdhënies së integruar, mësimi tematik dhe punës me projekte aktivitetet nga STEAM mund të përfshihen shumë natyrshëm në lojën dhe aktivitetet që fëmijët zhvillojnë në edukimin parashkollor. Fëmijët për nga natyra e tyre janë kurreshtar, ata ndërtojnë njohuritë dhe të kuptuarit e tyre për botën duke vëzhguar, duke bërë pyetje dhe duke hetuar. Këto janë prirje natyrore që formojnë themelin për eksplorimin e hershëm të shkencës, teknologjisë, inxhinierisë, artit dhe matematikës. Prandaj ky kurs ka për qëllim të ofrojë mënyra sesi mund t'i ushqejmë këto prirje dhe të ndërtojmë mjedisin dhe përdorim atë me qëllim që të zhvillojmë këto prirje. Praktika më e mirë në edukimin STEAM ndihmon profesionistët që të krijojnë një mjedis social i cili natyrshëm përfshin fokusin në të menduarit kritik, bashkëpunimin dhe të tjerët, ngritjen e hipotezave, të punuarit së bashku, komunikimin me të tjerët, marrjen e vendimeve, zgjidhjen e problemeve, etj. Prandaj ndërthurja e aktiviteteve përmes disiplinave të STEAM përmes aktiviteteve të planifikuara dhe atyre të paplanifikuara frymëzojnë dhe nxisin dëshirat e natyrshme të fëmijëve për të eksploruar gjë e cila mundëson që të nxënit e fëmijës të jetë në përputhje me interesat dhe nevojat e tij.

EDUKIMI STEAM NË ARSIMIN FILLOR (Z)

Në këtë kurs, mësimdhënësit para shërbimit do të shqyrtojnë përfshirjen e STEAM (Shkencë, Teknologji, Inxhinieri, Artë dhe Matematikë) në mësimdhënie dhe të nxënit në arsimin fillor. Integrimi i STEM është i rëndësishëm për nxënësit e tyre në të ardhmen dhe zhvillimin e shkathtësive të tyre për jetë e punë, prandaj kursi do të fokusohet në qasjet mësimore të bazuara në STEAM dhe praktikat më të mira. Kursi u ofron mundësi studentëve-mësimdhënës, të përfshihen në projektet-STEAM dhe të përgatiten për planifikimin e

aktivitete për arsimin fillor që strukturojnë mjedisin e klasës me aktivitetet mësimore dhe burimet gjatë një programi arsimor STEAM.

EDUKIMI STEAM NË ARSIMIN E MESËM (Z)

Përmbajtja e shkurtër: Në këtë kurs, mësimdhënësit para shërbimit do të shqyrtojnë përfshirjen e STEAM (Shkencë, Teknologji, Inxhinieri, Artë dhe Matematikë) në mësimdhënie dhe të nxëniet në shkollat e mesme të ulta. Integrimi i STEM është i rëndësishëm për nxënësit e shkollave të mesme të ulta sepse u ndihmon atyre të zhvillojnë njohuritë, shkathtësitë dhe të orinetohen për studime në të ardhmen. Kursi u ofron mundësi studentëve-mësimdhënës, të përfshihen në projektet-STEAM dhe të përgatiten për planifikimin e aktiviteteve, të strukturojnë mjedisin në klasë dhe jashtë saj dhe të shfrytëzojnë burimet e nevojshme për aktivitetet mësimore.

EDUKIMI STEAM NË ARSIMIN E LARTË (Z)

Ky kurs fokusohet në qasjet dhe praktikën më të mira mësimore të bazuara në STEAM, duke përfshirë mënyrën se si edukatorët në arsimin e lartë strukturojnë mjedisin e klasës, aktivitetet mësimore dhe burimet gjatë një programi arsimor STEAM.

HULUMTIMI I VEPRIMIT NË EDUKIMIN STEAM (O)

Ky kurs është planifikuar me qëllim të njohjes me hulumtimin në veprim si një formë e kërkimit sistematik dhe si proces i reflektimit për praktikën mësimore. Në kurs do të shqyrtohen karakteristikat themelore të hulumtimit në veprim dhe hapat e realizimit të një hulumtimi në klasë. Shqyrtimi kritik i literaturës për praktikën bashkëkohore të mësimdhënies në përgjithësi dhe atyre që bazohen në edukimin STEAM në veçanti, do të shërbejnë jo vetëm për identifikimin e problemeve në mësimdhënie dhe të nxëniet por edhe në planifikimin e planeve të veprimit dhe të gjithë hapave tjerë për implementimin e një projekti hulumtues. Gjatë kursit, studentët do të analizojnë një shumëllojshmëri të perspektivave të hulumtimit në veprim, bazën teorike, etikën, proceset dhe llojet e hulumtimit në veprim. Theksi vihet në atë se si hulumtimi mund të bëhet një mjet jetik dhe i rëndësishëm për mësimdhënësit dhe udhëheqësit arsimorë për të lehtësuar të nxëniet e nxënësve dhe në veçanti për të përmirësuar praktikën mësimore që bazohen në qasjen STEAM.

BARAZI NË EDUKIMIN STEAM (O)

Kursi merr parasysh kompleksitetin e drejtësisë sociale siç zbatohet në arsim dhe reflekton mbi qëllimet dhe vlerat e ndryshme të edukimit në kontekste të ndryshme, duke diskutuar koncepte të ndryshme të 'drejtësisë' dhe 'barazisë'. Ndërgjegjësimi, njohuria dhe të kuptuarit e pabarazive sistematike janë gurëthemeli për mësimdhënie efektive dhe adresimin e nevojave individuale të nxënësve, veçanërisht nxënësve nga grupet e marginalizuara. Si i tillë, kursi ka të bëjë me eksplorimin e diversitetit në shoqëri, me trajtimin e pabarazive, stereotipeve dhe mënyrat se si këto të fundit mund të ndikojnë në praktikën tonë mësimore. Studentët do të analizojnë çështje si menaxhimi i klasës, mësimdhënia, planifikimi, vlerësimi dhe komunikimi përmes prizmit të diversitetit, drejtësisë dhe barazisë në edukim. Duke ndërtuar vetëdijen për një shumëllojshmëri këndvështrimesh, studentët do të kuptojnë më mirë se si të nxisin një sistem arsimor më të barabartë për të gjithë nxënësit.

TEZA E MASTERIT

Tema e masterit përmban 20 ECTS dhe paraqet pjesën përfundimtare të Programit Master. Rregullorja e studimeve Master rregullon pikat e përgjithshme të procedurave dhe rregullave të realizimit të punimit përfundimtar –Tezës së masterit. Për shkrimin e temës duhet të zbatohen këto kriterë:

1. Tema duhet të ketë 15, 000 –20, 000 fjalë, në fontin 12, Times Neë Roman.
2. Referencat dhe citimi duhet të bëhen sipas standardit të APA-s (American Psychological Association).
3. Tema duhet të demonstrojë aftësinë e studentit për të zbatuar metodat dhe teorinë e hulumtimit shkencor në profilin e caktuar.

4. Tema duhet të demonstrojë aftësitë e studentit për të reflektuar dhe për të bërë punë hulumtuese në fushën përkatëse.
5. Tema duhet të demonstrojë njohuritë, shkathtësitë teorike dhe analitike të studentit, për të treguar familjarizimin e tij/saj me terminologjinë, aspektet dhe zhvillimet në fushën përkatëse.
6. Temën e punimit e zgjedh vetë studenti në konsultim me personelin akademik të fakultetit, e cila më pas duhet të aprovohet nga Këshilli i Fakultetit përmes departamentit apo kolegjiutit varësisht si përcaktohet me aktet që rregullojnë këtë fushë. Kur studenti regjistrohet 13 për të shkruar temën, duhet t'i caktohet edhe afati i përfundimit të saj, ndërsa studentët inkurajohen të nisin diskutimet me personelin akademik për temën para semestrit të tretë.
7. Tema e zgjedhur duhet të jetë e ndërlidhur me programin e studimit si dhe relevante për fushat prioritare hulumtuese të Fakultetit dhe për zhvillimin e sistemitshkollor në vend.
8. Përmbajtja akademike dhe aftësitë shprehëse të studentit duhet të jenë në harmoni me rregullat e drejtshkrimit.
9. Temat e shkruara në gjuhën shqipe duhet të kenë të shkruar përmbledhjen edhe në gjuhën angleze, e nëse tema shkruhet në gjuhën angleze, përmbledhja duhet të jetë e shkruar edhe në gjuhën shqipe.